

## DEKLARATË

1. Ne, asambleistët e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, përfaqësues të qytetarëve të Prishtinës, pavarësisht përkatësisë dhe orientimeve politike, përmes kësaj deklarate, shprehim shqetësimin dhe kundërshtimin tonë lidhur me ndalimin dhe mbajtjen e padrejtë të z. Ramush Haradinaj nga institucionet e Drejtësisë në Francë, me fletëarrest të lëshuar nga Serbia.
2. Vendimin për ndalimin e tij nga Shteti mik Franca, e konsiderojmë si të padrejtë dhe të pajustificueshëm, sepse ish-komandanti i Zonës Operative të Dukagjinit dhe ish-Kryeministri, Ramush Haradinaj, e ka dëshmuar me shkuarjen vullnetare në Tribunalin e Hagës, i cili Tribunal në të dy shkallët e vendosjes e ka konfirmuar pafajësinë e tij dhe e shpalli të pafajshën në të gjitha aktakuzat, duke e lënë atë të lirë.
3. Ne besojmë fuqishëm se Lufta e UÇK-së dhe z. Ramush Haradinaj, ka qenë çlirimtare dhe e pastër, pavarësisht tendencave të Serbisë për ta kriminalizuar atë. Ne e çmujmë lart kontributin e z. Ramush Haradinaj dhe familjes Haradinaj në luftën për Çlirim dhe të Pavarësisë e Shtetëndërtimit të Kosovës, dhe kërkojmë nga drejtësia e Francës që ta lirojë sa më parë.
4. Gjithashtu, kërkojmë edhe nga institucionet kompetente vendore dhe ndërkombëtare që të punojnë seriozisht, duke shfuqizuar të gjitha fletarrestet e ngritura nga Serbia dhe në ndërprejren e praktikave të ndëkjkes së ish-komandantëve dhe luftëtarëve të Lirisë në emër të aktakuzave fallse të ngritura nga një shtet, i cili edhe sot e kësaj dite nuk u pendua për gjenocidin e bërë ndaj Popullit Shqiptar.

**Prishtinë, më 07.02.2017**